



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

***Qeveria – Vlada - Government***

**PLATFORMA E QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
PËR DIALOGUN TEKNIK NDËRSHTETËROR  
MIDIS  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË**

---

Prishtinë, mars 2011

## Përmbajtja

---

1. Hyrje
2. Korniza parimore
3. Agjenda e dialogut
4. Objektivat e dialogut
5. Dialogu – një instrument për fuqizimin ndërkombëtar të Kosovës
6. Ekipi i dialogut

## 1. HYRJE

---

Qeveria e Republikës së Kosovës ka pranuar obligimin ndërkombëtar për të hyrë në dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, konform Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, A/RES/64/298 të datës 9 shtator 2010 dhe në përputhje me kompetencat kushtetuese të Qeverisë për të ushtruar sovranitetin shtetëror në politikën e jashtme të vendit sipas nenit 93, pika 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës hyn në këtë dialogun teknik me një platformë të qartë parimesh mbi ruajtjen dhe mbrojtjen e interesave nacionale, të mbrojtjes së Kushtetutës së vendit dhe të promovimit të interesave shtetërore në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës e konsideron dialogun teknik ndërshtetëror si një mundësi për Kosovën për t'u afruar më shumë në Bashkimin Evropian, për të nxitur një bashkëpunim më të madh rajonal dhe për të forcuar funksionalitetin e shtetit tonë. Me këtë dialog ne synojmë zgjidhjen e çështjeve teknike që kanë rënduar marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë që nga perioda e luftës. Zgjidhjet e çështjeve teknike kontribuojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve në të dyja vendet dhe ne do të angazhohemi që të gjitha zgjidhjet të jenë të avancuara dhe të mbështetura fuqishëm në parimet Euro-Atlantike . Për më tepër, duke gjetur zgjidhjet, Kosova do të përshpejtoj realizimin e synimeve të saja evropiane dhe euro-atlantike, duke vendosur marrëdhënie të mira fqinjësore dhe forcuar bashkëpunimin rajonal që janë ndër parakushtet themelore për stabilitetin, zhvillimin ekonomik dhe integrimet evropiane. Me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara, si partnerët më të rëndësishëm ndërkombëtarë të Kosovës, Qeveria e Kosovës është e bindur se dialogu teknik midis Kosovës dhe Serbisë do të konsolidojë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës.

Kjo Platformë mbi dialogun teknik ndërshtetëror midis Kosovës dhe Serbisë përmban kornizën parimore, agjendën e dialogut, objektivat e tij, përfitimet e mundshme në fuqizimin e shtetit të Kosovës, përshpejtimin e integriteteve evropiane dhe euro-atlantike si dhe strukturën dhe organizimin e ekipit për dialog si bartëse e këtij procesi.

## 2. KORNIZA PARIMORE

---

Qeveria e Republikës së Kosovës në dialogun teknik do të ketë për bazë këtë kornizë parimesh. Këto parime mbështetet në Kushtetutën e vendit, Rezolutën e Parlamentit të Kosovës të datës 10 mars 2011 dhe në obligimet ndërkombëtare lidhur me dialogun.

### A. Parime të përgjithshme

**Qeveria e Republikës së Kosovë ka pranuar dialogun teknik,**

1. *Duke marrë parasysh* qëllimet dhe parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në planin e politikës së jashtme:
  - se shteti pavarur dhe sovran Kosovës zotohet të kontribuojë në stabilitetin e rajonit dhe të mbarë kontinentit evropian, duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë dhe të bashkëpunimit të mirë me të gjitha shtetet fqinje,
  - të bindur që shteti i Kosovës do të jetë anëtar i denjë i familjes së shteteve paqedashëse në Botë,
  - me synimin që shteti i Kosovës të avancojë në proceset integruese Euro-Atlantike.
2. *Në zbatim* të kompetencave të saja kushtetuese në politikën e jashtme në bazë të nenit 93 pika 1 që thotë se “Qeveria propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit”,
3. *Duke respektuar* Rezolutën e Asamblesë së përgjithshme të OKB-së, A/RES/64/298 të datës 9 shtator 2010, e cila njeh mendimin këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi përputhshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës me të Drejtën Ndërkombëtare; dhe njëherit mirëpret gatishmërinë e Bashkimit Evropian për të lehtësuar dialogun midis dy palëve, duke vlerësuar dialogun si një faktor paqeje, sigurie dhe stabiliteti në rajon dhe si promotor i bashkëpunimit dhe përparimit drejtë Bashkimit Evropian dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve në të dyja vendet.
4. *Duke marrë parasysh* që Dialogu teknik ofron mundësi për implementimin e reformave institucionale dhe legale në përputhje me legjislacionin e BE-së ( *acquis communautaire*) që do të mundësojë të dyja shtetet, Republikën e Kosovës dhe Republikën e Serbisë, të jenë në harmoni më të madhe me normat dhe standardet evropiane.

5. *Duke marrë mbështetjen e Grupit Drejtues për Kosovën për një dialog teknik midis dy shteteve të pavarura, Kosovës dhe Serbisë, të shprehur në deklaratën e datës 8 shkurt 2011 pika 6.*
6. *E vetëdijshme se bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe dialogu janë çështje kyçe për stabilitetin, zhvillimin ekonomik dhe parakushte për integrimin në Bashkimin Evropian*
7. *Në respektim të plotë të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës të datës 10 mars 2011.*

## **B. Parimet e dialogut teknik**

1. Dialogu teknik midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë është dialog midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane i cili do të përfshijë vetëm çështjet teknike të interesit të përbashkët, pa prekur në asnjë rast sovranitetin e Kosovës, pavarësinë, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetues të Kosovës.
2. Dialogu është i ndërmjetësuar dhe lehtësuar nga Bashkimi Evropian, i cili është në pozitën më të mirë për udhëhequr këtë proces drejtë zgjidhjeve duke avancuar perspektivën evropiane të palëve.
3. Agjenda e dialogut përcaktohet përmes marrëveshjes së palëve pjesëmarrëse dhe lehtësuesit të dialogut.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës udhëheq dialogun përmes përfaqësuesit/es të emëruar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.
5. I/e emëruari/a nga Kryeministri udhëheqës i delegacionit të Republikës së Kosovës për dialogun me Republikën e Serbisë, do të ofrojë raporte, do të informojë në baza të rregullta Komisionin për Politikë të Jashtme dhe komisionet tjera përkatëse të Kuvendit të Kosovës dhe do të raportojë në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës.
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës do të ratifikojë marrëveshjet e arritura në dialogun teknik që kanë obligime traktati, në bazë të kompetencave kushtetuese për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që i nënshkruan Qeveria e Republikës së Kosovës.

### **C . Parimet e panegociueshme**

Dialogu teknik nuk do të shkel në asnjë rast parimet e panegociueshme të definuar qartë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Këto parime të panegociueshme janë:

1. Statusi i Kosovës është i zgjidhur. Kosova është shtet i pavarur, sovran me integritet territorial të paprekshëm dhe kushtetutë moderne të njohur ndërkombëtarisht. Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësi ka konfirmuar ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës më 22 korrik 2010. Shteti i Kosovës është njohur nga pjesa më e fuqishme e bashkësisë ndërkombëtare, nga 75 shtete në mesin e të cilëve SHBA, shumica e shteteve të Bashkimit Evropian, shtetet e rajonit e më gjerë. Kosova është anëtare e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe procesi i njohjeve është në rritje.
2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.
3. Rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovrane e institucioneve shtetërore, e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
4. Plani i Ahtisarit është platforma për rregullimin e të drejtave dhe garancive për komunitetet dhe i njëjti është integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Plani i Ahtisarit ofron kompetenca të veçanta për komunitetin serb, dhe si i tillë madje është më shumë se që ofron e drejta ndërkombëtare për minoritetet.

### 3. AGJENDA E DIALOGUT

---

Agjenda e dialogut teknik përfshinë, mes tjerash, çështjet dhe problemet teknike të krijuara në periudhën e luftës dhe të pasluftës si dhe çështjet e bashkëpunimit rajonal. Lista vijuese nuk është shtrruese.

#### 1. Çështjet dhe problemet e krijuara në periudhat e luftës dhe të pasluftës përfshinë:

- Kthimi i dokumentacionit të marrë nga Serbia (dokumentacionit kadastral, dokumentacionin e gjendjes civile etj.)
- Çështjet e ndërhyrjes ilegale të Serbisë në fushën e, energjisë, telekomunikacionit, etj.
- Kthimi i eksponateve të trashëgimisë kulturore të marra/huazuara nga Serbia; Mbrojtja e trashëgimisë religjioze dhe kulturore në Kosovë
- Çështja e gjetjes së personave të zhdukur
- Kthimi i personave të zhvendosur në shtëpitë dhe pronat e tyre
- Çështja e kthimit të fondit pensional për qytetaret e Kosovës
- Marrëdhëniet tregtare midis Kosovës dhe Serbisë ( njohja e vulave doganore, normalizimi i eksport- importeve të mallrave midis dy vendeve)
- Dëmshpërblimi për dëmet e luftës nga ana e Serbisë
- Çështjet që ndërlidhen me sukcesionin e ish Jugosllavisë
- Demarkacioni i vijës kufitare midis Kosovës dhe Serbisë në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n dhe COMKFOR-in.

#### 2. Çështjet e bashkëpunimit rajonal përfshinë:

- Pjesëmarrja e plotë dhe barabartë e të dyja vendeve në mekanizmat dhe iniciativat rajonale
- Eliminimi i pengesave për lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë nëpër të dyja vendet dhe në rajon. Çështjet përfshinë njohjen e pasaportave, dokumenteve dhe tabelat e regjistrimit të veturave, etj.
- Aranzhimet rajonale, përfshirë CEFTA-në, Traktatin e Athinës për Energji, etj. dhe transporti ndërkufitar siç janë transporti rrugor, hekurudhor dhe ajror
- Eliminimi i pengesave të cilat parandalojnë Kosovën dhe Serbinë për të hyrë në aranzhmane rajonale.

## 5. OBJEKTIVAT E DIALOGUT

---

- Përmirësimi i jetës së qytetarëve në aspektin ekonomik-social
- Fuqizimi i shtetit të Kosovës
- Avancimi i agjendës evropiane për Kosovën
- Avancimi i agjendës euro-atlantike për Kosovën
- Harmonizimi i praktikave rajonale, normave dhe ligjeve, me parimet e *acquis communautaire* të BE-së
- Përmirësimi i bashkëpunimit rajonal
- Afirmimi i pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës para bashkësisë ndërkombëtare, që do të shpiej tek rritja e numrit të njohjeve dhe anëtarësimi i Kosovës në organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe institucioneve tjera ndërkombëtare
- Normalizimi i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, përfshirë përfundimisht njohjen e pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë.



## 5. DIALOGU TEKNIK – NJË INSTRUMENT PËR FUQIZIMIN NDËRKOMBËTAR TË KOSOVËS

---

Gatishmëria e Kosovës për të hyrë në dialog teknik me Serbinë dhe qasja e saj konstruktive kanë krijuar një vlerë të re për shtetin e ri të Kosovës në planin e politikës së jashtme e cila do të shfrytëzohet për fuqizimin ndërkombëtar të Kosovës

Bashkimi Evropian e ka siguruar Qeverinë e Republikës së Kosovës se dialogu teknik do t'i shërbejë afrimit të Kosovës me Bashkimin Evropian. Shtetet e Bashkuara mbështesin këtë proces, dhe bashkësia ndërkombëtare, përmes Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB të datës 9 shtator 2010, ka afirmuar po të njëjtin qëndrim.

Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë diplomatike që definojnë qartë se çfarë do të jenë përfitimet konkrete të Kosovës në rrugën tonë drejt Bashkimit Evropian. Ky angazhim do të jetë i fokusuar dhe kërkon që të gjithë mekanizmat diplomatik përfshirë edhe diplomacinë parlamentare të angazhohen drejt këtij qëllimi.

Në të njëjtën kohë, ky dialog është një argument shtesë në lobizimet për njohje të reja dhe në veçanti me pesë vendet e BE-së të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën.

## 6. EKIPI PËR DIALOG

---

Duke marrë parasysh formatin e dialogut të paracaktuar nga ndërmjetësuesi i BE-së, sipas të cilit dialogu do të udhëhiqet nga përfaqësuesit e dy palëve, të mbështetur nga komponente teknike dhe këshilluese, është dizajnuar struktura dhe përmbajtja e ekipit për dialog.

Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri është emëruar Udhëheqëse e Dialogut nga ana e Kryeministrit Hashim Thaqi.

**Udhëheqësja e Dialogut** koordinon procesin e dialogut dhe vendimmarrjen me Kryeministrin dhe anëtarët tjerë të Qeverisë. Udhëheqësja e dialogut i përgjigjet dhe i raporton drejtpërsëdrejti Kryeministrit dhe Kuvendit të Kosovës në harmoni me Rezolutën e Kuvendit të datës 10 mars 2011. Kryeministri koordinon procesin e dialogut me Presidenten.

Dialogu lidhet me çështjet praktike të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësitë e ministrive dhe agjencive përkatëse. Ministrat dhe ministritë janë përgjegjës për hartimin e platformës për dialog për çështjet në kompetencat e tyre dhe dokumentacion tjetër mbështetës, emrimin e grupit teknik, koordinatorit të grupit për dialog. Në rastet kur çështjet bien në kompetencat e zyrës së Kryeministrit, Zëvendëskryeministri përkatës do të jetë përgjegjës. Qeveria dhe ekipi i dialogut do të angazhojnë edhe ekspertë nga agjencitë e pavarura, shoqëria civile dhe ekspertë ndërkombëtarë, varësisht nga nevoja.

**Ekipi i Udhëheqëses së Dialogut** do të krijojë një strukturë mbështetëse të përbërë nga disa nivele dhe komponente në mënyrë që të angazhojë të gjitha elementet të vendit tonë në këtë proces për zgjidhjen e çështjeve me interes për vendin. Struktura përbëhet nga disa nivele apo komponentë:

- a. Ekipi i ngushtë i Udhëheqëses së Dialogut
- b. Grupet teknike të dialogut (ekipet ndër-institucionale)
- c. Grupi këshillues (përfaqësues të spektrit politik, shoqëria civile, këshilltarë ndërkombëtar, etj)
- d. Sekretaria e ekipit të dialogut

**a) Ekipi i ngushtë i Udhëheqëses së Dialogut** përbëhet nga një ekip që do ta mbështet Udhëheqësen gjatë tërë procesit të dialogut pavarësisht se cilat tema dialogohen. Ky ekip përbëhet nga tre komponentë:

- **Kabineti i Kryeministrit:** jep kontributin në dialog dhe njëkohësisht shërben si lidhje e drejtpërdrejtë mes delegacionit dialogues dhe Kryeministrit. Pjesëmarrja

e kabinetit të Kryeministrit është e nevojshme gjithashtu për dhënien e rëndësisë së dialogut dhe ndihmon në procesin e menaxhimit të grupeve teknike;

- **Kabineti i Presidentes së Kosovës:** jep kontributin në dialog dhe njëkohësisht shërben si lidhje e drejtpërdrejtë mes ekipit të dialogut dhe Presidentes. Po ashtu, mbanë të informuar Presidenten për rrjedhat e dialogut krahas raporteve zyrtare të Udhëheqëses së dialogut.
- **Këshilltarët e Zëvendëskryeminstres/Udhëheqëses së Dialogut:** këshilltarët shërbejnë për dhënien e këshillave për ZVKM, dhënie të këshillave në qasje, dhe në marrje të vendimeve më të informuara. Grupi i këshilltarëve shërben edhe në koordinimin dhe monitorimin e grupeve teknike;
- **Zyrtarët ndërlidhës të Ministrisë për Punë të Jashtme dhe të Ministrisë së Integritimit Evropian:** shërbejnë si ndërlidhës me ministrat përkatës dhe ofrojnë mbështetjen e nevojshme profesionale në fushën e politikës së jashtme dhe të integritimit evropian.
- **Zyra për Planifikim Strategjik e Kryeministrit (ZPS):** Ofron mbështetje në procesin e planifikimit, analizave dhe ndërlidhjen e aspekteve të ndryshme planifikuese të Qeverisë dhe kryerjen e analizave. ZPS i ndihmon Udhëheqëses së Dialogut rreth aspekteve metodologjike dhe teknike përgjatë gjithë procesit të dialogut. ZPS analizon dokumentet, materialet dhe propozimet e grupeve teknike të Qeverisë. ZPS bën harmonizimin e të gjitha analizave të Grupit Teknik (GT) në dokumente të lexueshme dhe të qarta për delegacionin si dhe ndihmon në formulimin e pozicioneve në dialog si dhe zgjedhjen e opsioneve që vijnë nga grupet teknike. Pjesëmarrja e ZPS në këtë nivel dhe involvimi në të gjitha proceset e dialogut është me rëndësi për arsye të ndryshme me theks të veçantë në njoftim dhe informim me procesin e dialogut dhe do të shërbej si memorie institucionale e dialogut.

**b) Grupet Teknike (GT):** Janë grupe të ekspertëve të fushave të caktuara, të emëruar dhe të udhëhequr nga Ministrat e linjës. Grupet teknike përgatisin dokumentacionin për dialog në bashkëpunim me ZPS. Dokumentacioni për dialog përmbanë: dokumentin për pozicionin, dokumentet analitike dhe faktografike, etj. Dokumentet e përgatitura duhet të aprovohen nga ministri përkatës para se t'i dorëzohen Udhëheqëses së Dialogut. Grupet teknike udhëhiqen nga koordinatorët teknik të emëruar nga ministrat e linjës për secilën fushë që dialogohet. Këto grupe teknike janë elementi ku ekipi i dialogut do të bazohet për mbështetje për fushat që dialogohen. Koordinator merr pjesë në dialog si pjesë e ekipit të udhëheqëses së dialogut,

ndërsa grupet teknike marrin pjesë në dialogim në nivel ekspertësh. GT do të përbëhet nga persona që janë kompetent në lëmin që dialogohet përfshirë këtu përfaqësues të institucioneve përkatëse ose ekspertë tjerë të jashtëm. Në thelb, parimi i homologialitetit do jetë praktikë në rastin e udhëheqjes apo përfaqësimit në takimet me palën e Serbisë.

Koordinatori teknik gjithashtu shërben si këshilltar profesional i Udhëheqëses së dialogut për fushën përkatëse, si dhe përgatit raportin nga procesi i dialogut në Bruksel. Raporti i dorëzohet Udhëheqëses së Dialogut dhe ministrit të linjës.

Për çështjet në kompetencat e drejtëdrejta të zyrës së Kryeministrit, zëvendëskryeministri përgjegjës udhëheq procesin e përgatitjes dhe koordinimit me Udhëheqësen e Dialogut.

**c) Grupi këshillues (përfaqësuesit e gjithë partive politike, shoqëri civile, këshilltarë ndërkombëtarë, etj)** - Për të siguruar një formë të konsultimit të gjerë të spektrit politik dhe shoqëror në procesin e dialogut me Serbinë, delegacioni në një formë apo tjetër do të përfshijë përfaqësues të gjithë spektrit, shoqërisë civile, këshilltarë ndërkombëtarë, etj. Pjesëmarrja e gjerë do të jetë kontribues i legjitimitetit të procesit të bisedimeve.


**d) Sekretaria e ekipit të dialogut** – kryen punët e natyrës logjistike për ekipin e dialogut.

**Ekipi i dialogut në bisedimet në Bruksel:** përbëhet nga udhëheqësja e dialogut, një këshilltar politik dhe koordinatori i grupit teknik për fushën për të cilën diskutohet. Varësisht nga çështjet që diskutohen, Udhëheqësja do të ketë në delegacion koordinatorin e grupit teknik për çështjen përkatëse. Po ashtu, varësisht nga nevoja, grupet teknike angazhohen në dialog në nivel ekspertësh, me çrast pjesë e grupit do të jetë një këshilltar politik nga ekipi i ngushtë i Udhëheqëses së dialogut, për koordinimin e qëndrimeve politike dhe teknike.

**Raportimi dhe mbikëqyrja:** i gjithë procesi i dialogut do të raportohet te Kryeministri, Presidentja dhe Kuvendi. I gjithë procesi i dialogut do të monitorohet nga, Kryeministri, Presidentja dhe Qeveria në rend të parë dhe Kuvendi si institucioni më i lartë shtetëror dhe kushtetues.

Qeveria do të akordojë një **buxhet** për të mbështetur punën e ekipit për dialog.

## STRUKTURA E EKIPIT TË DIALOGUT



KKM= Këshilltari i Kryeministrit  
 KSH= Këshilltari i Zv. Kryeministres  
 KP = Këshilltari i Presidentes  
 ZPS= Zyra për Planifikim Strategjik  
 SHC= Shoqëria Civile  
 KN = Këshilltarët Ndërkombëtarë